

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Ndërkombëtar - Raport “Për legjislacionin ekzistues, praktikat dhe perspektivat për dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe të magazinuar në Shqipëri”, i IFC/ WB Group, Korrik 2022
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për Miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027” Programi Qeverisës 2021-2025
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	14.08.2023
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	22.06.2023
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2023 – MBZHR– Nr.1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Julinda Bare <i>e-mail-i:</i> julinda.bare@bujqesia.gov.al Entela Kola <i>e-mail-i:</i> entela.kola@bujqesia.gov.al Adra Gjongecaj <i>e-mail-i:</i> adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p>Problemet dhe shkaqet në sektorin e bujqësisë janë pamundësia e fermerëve për të marrë financime apo vështirësitë për të përfituar kredi bujqësore, pasi kreditë në këtë fushë konsiderohen me risk të lartë nga ana e bankave. Aktualisht përdorimi i produkteve bujqësore si koletaral është i pamundur. Problematika e njëjtë shtrohet edhe me tokën bujqësore e cila nuk është e mundur të përdoret si kolateral si pasojë e mungesës së dokumentacionit të pronësisë.</p> <p>Një tjetër problematikë po aq e rëndësishme është formalizimi dhe rregullimi përmes ligjit të posaçëm i marrëdhënies faktike që është konstatuar tashmë në terren. Kjo është një marrëdhënie shit-blerje mes fermerit dhe një blerësi i cili paraprakisht hyn garant për të blerë produktin e ardhshëm bujqësor që do kultivojë/prodhojë fermeri. Në mungesë të një ligji i cili rregullon dhe ofron mbrojtje në mënyrë të posaçme për fermerin është konkluduar se në këtë marrëdhënie shpesh</p>	

blerësi abuzon me pozicionin e tij p.sh si në rastin e ngritjes së pretendimeve lidhur me cilësinë, sasisë etj. të produktit bujqësor duke i përdorur si mënyrë për të ulur çmimin real.

Duke pasur në vëmendje këto problematika, si në aspektin financiar po kështu edhe në mungesën e një mbrojtje ligjore në marrëdhëniet tregëtare për produktet bujqësore të ardhshme që fermerët në Shqipëri hasin, lindi domosdoshmëria e propozimit të një politike të re .

Me instrumente financiare alternative kërkojmë të krijojmë një qasje të re orientuar drejt rezultateve, ku fermerëve u krijohet një mundësi për financime si përmes sistemit bankar apo/edhe si hallkë e zinxhirit bujqësor të vlerave, sepse vetë produkti bujqësor, vetë kultura bujqësore, qoftë ajo e ruajtur në magazinë apo produkti bujqësor, i cili gjendet në prodhim e sipër do të mund të përdoret si kolateral.

Vështruar në pikëpamjen e plotësimit të kuadrit ligjor institucional i cili synon të reflektojë dhe konsolidojë qëllimet e politikave dhe arritjet e reformave të realizuara në përputhje me strategjinë e Bashkimit Europian në bujqësi si një nga sektorët me të rëndësishëm dhe me përparësi.

OBJEKTIVAT

Me anë të këtij propozimi synohet që:

- Të sigurohen sa më shumë financime në bujqësi.
- Të pajisen fermerët me deftesën tregëtare, me qëllim përfitimin e kredive bankare më përqindje më të ulët brenda një afati 3 vjecar. Zbatimi i kësaj objektivë bëhet i matshëm përmes numrit të dëftesave tregëtare të lëshuara, për periudhën 3 vjecare nga momenti i ngritjes dhe funksionimit të regjistrimit elektronik në sistemin e-Albania.
- Të rregullohen ligjërisht-marrëdhëniet tregëtare duke rritur sistemin e gjurmshmerisë së produkteve bujqësore nga ferma në tavolinë në të njëjtën kohë brenda 3 viteve. Njësi matëse mund të jetë rritja e numrit të fermerëve të paisur me kartën e fermerit duke mbështetur kështu rolin e fermerit përmes formalizimit të tij.
- Të sigurohet pagesë e shpejtë dhe e drejtë për fermerin për produktin bujqësor të ardhshëm dhe atë të magazinuar.
- Të krijohet një sistem kolateral bujqësor nëpërmjet produktit bujqësor të ardhshëm apo atij të magazinuar. Matje e kësaj objektivë mund të kryhet duke rritur bashkëpunimin me bankat, për marrjen e informacionit sa është arritur të përdoret produkti bujqësor përmes deftesës tregëtare si kolateral për një periudhë të paktën 5 deri 10 vite nga momenti i miratimit të ligjit.

OPSIONET E POLITIKAVE Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- Opsioni 0 (*status quo*): Ky opsion do të thotë të vijohet të mbeten problematikat aktuale duke mos u adresuar zgjedhja e tyre. Nuk do të ketë ndërhyrje me propozimin e politikës së re. Ruajtja e status-quo-së con në mos përmbushjen e objektivave.
- Opsioni 1: *Hartimi i një ligji “Për dëftesat tregëtare mbi produktet bujqësore”*- ky është opsioni i cili bën të mundur propozimin e politikës së re përmes së cilës rregullohet dhe vjen

si risi në vëndin tonë: parashikimine dy instrumente të reja financiare në dobi të fermerit si dhe ofrimin e mbrojtjes së këtij të fundit nga abuzimet e mundshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregëtare nga ai.

- Opsioni 2: *Rishikimi i bazës ligjore ekzistuese*- ky opsion do të thotë rishikimin e bazës ligjore ekzistuese por në rastin tonë propozimet që sjell ky projektligj, dëftesat tregëtare, si instrumente financiare në bujqësi janë risi për vëndin tonë dhe nuk janë parashikuar më parë me akte të tjera ligjore.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik:

Kosto jo të drejtpërdrejta ekonomike janë krijimi i regjistrimit të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore në platformën e-Albania, shpenzimet për këtë janë marrë përsipër të mbështeten nga projekti SECO (Sekretariati Ekonomik i Zvicrës) për një periudhë 3 vjecare nga momenti i krijimit dhe funksionimit të tyre.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin privat: Nuk identifikohen kosto në sektorin privat me miratimin e këtij projektligji, pasi edhe lëshimi i dëftesave tregtare online, nëpërmjet modulit të dedikuar në platformën e-Albania do të jetë pa pagesë.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat- Fermerët kanë mundësi të financohen menjëherë para se të fillojnë kultivimin e produkteve bujqësore dhe me këtë mekanizëm shpeshherë të kenë të garantuar edhe shitjen e tyre. Po ashtu fermerët kanë mundësi, që ta shtyjnë shitjen e produkteve bujqësore në një moment të dytë, kur çmimet në treg të jenë më të larta dhe duke përdorur instrumentin financiar të dëftesave tregtare mbi produktin e magazinuar, të përfitojnë financime nga bankat apo institucionet e tjera.

Përfitimet ekonomike për sektorin publik- Duke u rritur të ardhurat në sektorin e bujqësisë edhe buxheti i shtetit përfiton më shumë të ardhura nga ky sektor, rritet numri i të punësuarve, si dhe të hyrat në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Ndikimi social i drejtpërdrejtë- Rritja e punësimit si dhe rritja e prodhimit bujqësor në fshat dhe në sektorin e agropërpunimit. Parashikimi ligjor i këtyre instrumenteve financiare në vëndet ku aplikohet ligji ka dhënë hov bujqësisë. Në këtë aspekt pritshmëritë e rritjes së eksportit të produkteve bujqësore të vëndit tonë janë të larta.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë- nëpërmjet këtij ligji parashikohet të aplikohen çmime më të arsyeshme për konsumatorin, si dhe produkte bujqësore më të kontrolluara dhe më cilësore.. Rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standartin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta.

Ndikimi në mjedis- Projektligji synon që të rrisë interesin e fermerëve për ta kultivuar tokën bujqësore dhe për të mos e përdorur për qëllime të tjera jo-bujqësore ç'ka ka sjellë pakësim të sipërfaqes të kultivuar dhe të kultivueshme. Duke i nxitur fermerët të zhvillojnë një bujqësi më

intensive, të standartizuar, të shëndetshme ku vec të tjerave synohet edhe ruajtja e biodiversitetit në zonat rurale.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet tregoi se opsioni 1, hartimi i ligjit “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore” është vlerësuar më me shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si opsionin e preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

Me këtë opsion të zgjedhur bëhet i mundur finalizimi i kuadrit ligjor, lidhur me rregullimin ligjor, formalizimin e marrëdhënieve “de facto”, mes fermerëve dhe tregtarëve, por duke ofruar tashmë dy instrumente të plota financiare, të cilat mundësojnë financimin e sektorit të bujqësisë në të gjitha hallkat e tij, që nga çasti i blerjes së lëndëve të para e deri në çastin, kur produkti bujqësor i shitet grumbulluesit/ agropërpunuesit apo konsumatorit dhe duke rritur garancitë ligjore për palët për përmbushjen e pritshmërive, nga dëftesat tregtare të lëshuara prej tyre si dhe duke ofruar mbrojtje ligjore për fermerin në veprimtarinë e tij tregëtare.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë) Kosto mujore për një sektor minimal 1+2, një përgjegjës sektori e dy specialiste afro 368 mijë page mujore shtojtë sigurimet e shtetit, për 12 muaj.

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
5,200,000	5,200,000	5,200,000

Organizata ndërkombëtare IFC/ WWB Group në partneritet me Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës SECO të cilët kanë zyrat e projekteve të tyre edhe në vëndin tonë, kanë marrë përsipër asistimin për një periudhë 3-vjeçare në zbatimin e këtij projektligji pas miratimit të tij.

Asistenca nga ana e tyre do të konsistojë në mbështetjen financiare për krijimin e sistemit të regjistrimit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore në platformën e-Albania, në hartimin e akteve nënligjore, trajnimin e punonjësve të Ministrisë që do të punojnë në njësinë e regjistrimit elektronik, të garantojë kapacitetet institucionale dhe administrative për zbatimin e ligjit si dhe organizimin e aktiviteteve informuese/trajnuese për përmbaruesit, institucionet financiare dhe mikrofinanciare, për fermerët, furnizuesit e lëndëve të para në bujqësi dhe për personat e tjerë të interesuar, në funksion të arritjes së qëllimit final për kontribimin dhe forcimin e një sektori të qëndrueshëm agroushqimor.

KONSULTIMI

Nga ana e një ekipi ekspertësh të IFC-së/ EB Group është ndërmarrë një studim në lidhje me legjislacionin ekzistues, praktikat dhe perspektivat për zbatimin eventual të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, apo siç njihen në praktikat ndërkombëtare si “Crop Receipts” dhe “Earehouse Receipts”, në periudhën Mars- Qershor 2022. Ky studim është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe duke përfshirë të gjithë operatorët privatë e shtetërorë të sektorit të bujqësisë. Në këtë kuadër janë mbajtur tre takime të zgjeruara consultative:

- Takim është mbajtur në datën 19 Prill 2022, në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural, ku kanë qenë të ftuar përfaqësues nga shoqatat e fermerëve, të agropërpunuesve, të furnizuesve të lëndëve të para në bujqësi, të grumbulluesve, të bankave, të institucioneve të mikrofinancës dhe të shoqërive të sigurimit. Nga përfaqësuesit e IFC-së u shpjegua praktika e mirë ndërkombëtare në zbatimin e këtyre dy instrumenteve financiare “Crop Receipts” dhe “Earehouse Receipts”, si dhe përfitimet që sjellin këto instrumente për të gjithë operatorët e sektorit. Nga ana e subjekteve të ftuara u shpjeguan problemet e mëdha që has sektori i bujqësisë për financim, për shkak të pamundësisë për t’u kreditur, për mungesë kolaterali, si dhe interesat e larta të kredive bankare apo të institucioneve të mikrofinancës, për sektorin e bujqësisë, që janë të papërballueshme për të ardhurat modeste të një fermeri të mesëm apo të vogël.

- Takim është zhvilluar me përfaqësues të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) në datën 10 maj. Takimi u zhvillua mes përfaqësuesve të AMF-së dhe përfaqësuesve të MBZHR-së, Bankës së Shqipërisë dhe ekspertëve të IFC-së, zj. L.Qorlazja, zj. B. Kraja, z. G. Ziu, zj. A. Gjongecaj. Në këtë takim u diskutua mbi konceptet që sjell projektligji i ri si dhe fushveprimi i tij në raport me ligjin nr. 60/2020 “Për tregjet e kapitaleve”. Sugjerimet dhe komentet nga ana e përfaqësuesve të AMF u morën parasysh si dhe u reflektuan në draftin e projektligjit.

- Takim është zhvilluar, në datën 18 maj mes përfaqësuesve të MBZHR-së, Bankës së Shqipërisë dhe ekspertëve të IFC-së, zj. L.Qorlazja, zj. B. Kraja, z. G. Ziu, zj. A. Gjongecaj në ambjentet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) të cilët përfaqësoheshin nga Zëvendësministri z. Endrit Yzeiraj. Në këtë takim u prezantua projektligji si dhe diskutua mbi konceptet dhe fushëveprimi i këtij projektligji.

- Takim është zhvilluar mes anëtarëve të grupit të punës, zj. A. Gjongecaj dhe drejtuesve të Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë (AREB) në datën 31 maj, ku u diskutua mbi mënyrën e ushtrimit të monitorimit në terren nga ana e AREB-ve, rast pas rasti, në përputhje me dispozitat e projektligjit, kur kjo do jetë e nevojshme dhe kur të kërkohet nga njësia përgjegjëse për regjistrin në ministri.

- Takim është mbajtur me datën 1 Qershor 2022 në mjediset e IFC-së me përfaqësues të operatorëve privatë të sektorit të bujqësisë. Në takim janë prezantuar gjetjet në legjislacion dhe praktikat faktike në marrëdhëniet mes fermerëve dhe furnizuesve të lëndëve të para, mes fermerëve dhe pikat të grumbullimit apo agropërpunuesve, mes fermerëve dhe bankave apo institucioneve të mikrofinancës. Në takim, operatorët sqaruan se këto instrumente financiare zbatoheshin “de facto” në mënyrë sporadike, por kreditorët nuk kishin asnjë garanci që e drejta e tyre për kthimin e financimit apo shkëmbimi me produkte bujqësore të ishte i garantuar. Rregullimi i tillë ligjor i këtyre aspekteve do ta intensifikonte këtë marrëdhënie tregtare, me përfitime për palët.

- Takim është mbajtur me datën 29 Qershor 2022, në mjediset e Hotel “Plaza” Tiranë, ku të pranishëm ishin: Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësues të lartë të IFC-së, përfaqësues të operatorëve privatë të sektorit të bujqësisë, të përmendur më lart. Në këtë takim u prezantua raporti i hartuar “Për legjislacionin ekzistues, praktikat dhe perspektivat për dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe të magazinuar në Shqipëri”, si dhe u miratua plani i veprimit për vijimin e punës në hartimin e ligjit të ri dhe zbatimin efikas të tij.

- Takim është zhvilluar në datën 19 korrik, mes përfaqësuesve të MBZHR-së, Bankës së Shqipërisë dhe ekspertëve të IFC-së, zj. L.Qorlazja, Z. V. Hoti, zj. B. Kraja, z. G. Ziu, zj. A. Gjongecaj në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë të cilët përfaqësoheshin nga z. B. Beja dhe zj. E. Rama. Në këtë takim u diskutua projektligji, konceptet, teknika legjislative, risia që sjell kjo politikë e re, struktura e draftit të projektligjit etj. Komentet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të MD-së u morën parasysh dhe u reflektuan.

- Kontribut vijues ka dhënë Shoqata Shqiptare e Bankave, si edhe Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë, të cilët kanë dhënë mendime me shkrim për përmirësimin e projektligjit.

- Projektligji iu është dërguar për mendim operatorëve privatë gjatë muajit Korrik 2023 dhe me datën 20 Korrik 2023 është mbajtur një takim i zgjeruar me ta, në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural, ku u diskutua projektligji në variantin përfundimtar. Të pranishmit shprehën mendimet e tyre në lidhje me problemet eventuale që mund të ketë në zbatim, pasi instrumentet financiare të parashikuara do të jenë komplet elektronike, nëpërmjet e-Albania-s dhe nganjëherë fermerët kanë pamundësi objektive, për të plotësuar si duhet aplikimet elektronike online.

Të pranishëmve iu la sërish një afat i arsyeshëm për të sjellë komente apo sugjerime mbi projektligjin.

Nga takimet e zhvilluara katër prej tyre kanë qënë me pjesëmarrje të zgjeruar konsultative mes grupeve të interesit, përfaqësues të bankave të niveleve të para, përfaqësues të shoqatave fermerësh, sipërmarrës të pikave të grumbullimit etj, takime këto që kanë patur edhe pasqyrimin përkatës mediatik, në faqet online, të institucioneve bashkëorganizuese.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen, sipas përcaktimeve të kësaj inisiative ligjore.

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit për dëftesave tregëtare mbi produktet bujqësore do të jenë:

- a) Struktura përgjegjëse për dëftesat tregëtare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- b) Kreditori sipas përcaktimeve të dispozitave të këtij projektligji;
- c) Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësore (AREB);
- d) Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU);
- e) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Struktura përgjegjëse për dëftesat tregëtare në MBZHR, është përgjegjëse për hartimin e politikave, programeve dhe legjislacionit që lidhet me sektorin e dëftesave tregëtare mbi produktet bujqësore. Kjo strukturë do administrojë një regjistër për dëftesat tregëtare, i cili do të krijohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në portoline-Albania sipas përcaktimeve të projektligjit. Gjithashtu do të bëjë koordinimin e procesit me shoqatat e fermerëve, pikat e grumbullimit, rast pas rasti dhe sipas nevojës që do të paraqitet për monitorim do të ketë koordinim me strukturën përkatëse AREB-et që mbulojnë zonat e caktuara.

Organizata ndërkombëtare IFC do të mundësojnë kryerjen e trajnimeve edhe me ekspertë të huaj, promovimin e ligjit me qëllim zbatimin sa më efikas të tij etj. të fermerëve por edhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në fushën e objektit të këtij projektligji.

Historik

Sektori i bujqësisë, zhvillimit rural përgjatë viteve të fundit ka pësuar transformime të rëndësishme dhe ka njohur një rritje progresive, kjo referuar treguesve të prodhimit, të ardhurave dhe të punësimit të familjeve rurale. Po kështu, janë pëmirësuar ndjeshëm edhe standartet e sigurisë ushqimore për konsumatorët.

Referuar të dhënave statistikore, për periudhën 2017-2020, bujqësia është orientuar drejt produkteve me avantazhe konkurruese dhe krahasuese, të cilat sigurojnë edhe të ardhura më të mëdha për njësi sipërfaqeje dhe që kanë potencial për eksport.

Në këto vite janë mbështetur dhe stimuluar ndryshimet në strukturën e mbjelljeve të produkteve bujqësore, në funksion të rritjes së prodhimit, zbatimit të standarteve të larta dhe plotësimin e kërkesave të tregjeve të brendshme dhe atij ndërkombëtar. Ndryshimet më të mëdha në strukturën e mbjelljeve kanë ndodhur kryesisht në vlerën e perimeve, pemëve frutore, ullinjve, agrumeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, luleshtrydheve etj., jo vetëm për plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm por duke arritur në mënyrë të konsiderueshme edhe volumet e eksporteve.

Vitet e fundit Shqipëria është karakterizuar nga stabiliteti makroekonomik. Rritja ekonomike është luhatur ndërmjet 3% dhe 4%, ndërsa inflacioni nuk e ka kaluar nivelin prej 3,6% gjatë viteve të fundit. PBB-ja për frymë në Shqipëri është rreth 447 000 lekë e barasvlershme me 3200 euro për frymë. Sipas INSTAT (2020), sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të shfrytëzuar (TBSH) në Shqipëri, përfshirë edhe livadhet dhe kullotat është 986,600 ha.192 (Aggregated data of MARD (2020), INSTAT (2020) and MARD (2021): Sector studies on fruits and vegetables, olives and ëine; established by AGT International/DSA in the frame of the GIZ-SRD Project, May 2021).

MBZHR-ja, gjatë viteve të fundit, në sajë të politikave që u përgjigjen nevojave të fermerëve, agropërpunuesve dhe sipërmarrësve në zonat rurale, të krijimit të strukturave të nevojshme dhe instalimit të instrumenteve të përshtatshme ka rritur ndjeshëm investimet në bujqësi dhe zhvillimin rural duke i përdorur me efikasitet maksimal burimet financiare në dispozicion. Burimet financiare të përdorura vijnë, si nga buxheti i shtetit, ashtu edhe nga financimet e BE-së dhe të donatorëve të ndryshëm, si dhe nga sistemi bankar, si BERZH-së, KFË, por edhe projektet bilaterale.

Në shkallë vendi funksionojnë rreth 224 pika grumbullimi (172 pika të grumbullimit të frutave dhe perimeve, 42 pika grumbullimi për bimët mjekësore dhe aromatike, si dhe 10 pika të tjera me destinacione të ndryshme. Nga 224 pika grumbullimi në total 60 pika grumbullimi kryejnë aktivitetin në qarkun e Fierit, 10 në Vlorë, 15 në Gjirokastër, 49 në Korçë, 11 në Elbasan, 15 në Berat, 12 në Tiranë, 19 në Durrës, 12 në Dibër, dhe 7 subjektë në Shkodër, Lezhe, dhe Kukës. Nga 172 pika grumbullimi të frutave dhe të perimeve 70 prej tyre garantojnë magazinim në dhoma frigoferike. Këto të fundit janë të lokalizuara kryesisht në qarqet e Korçës, Dibrës dhe Fierit. Pikat e grumbullimit bashkëpunojnë me rreth 35 mijë fermerë. Ato janë të shpërndara në të gjithë territorin ku zhvillohet bujqësi intesive dhe që kryesisht synojnë eksportin e produkteve agroushqimore.

Aktualisht, referuar të dhënave nga lista aktive e Drejtorisë së Tatimeve rezultojnë të regjistruar dhe të paisur me nipt fermeri (deri në datën 26 qeshor 2023) 95,793 fermerë në të gjithë Shqipërinë.

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i sektorit ekonomik nga bujqësia. Sektori bujqësor përjeton rritje të qëndrueshme, me formim vjetor të kapitalit fiks bruto (FBKF) prej rreth 53.7 milionë eurosh dhe rritje të produktivitetit vjetor (VSHB për njësi të fuqisë punëtore në bujqësi) prej 5,680 eurosh në vitin 2020. Kontributi i bujqësisë në totalin e vlerës së shtuar bruto të ekonomisë (VSHB) është rreth 22% ndaj VSHB-së kombëtare.

Në vitin 2019, 36.4% e forcës punëtore ishte në bujqësi, pylltari dhe peshkim me një rënie totale prej mbi 10% gjatë dekadës së fundit, për shkak të emigrimit dhe të rritjes së produktivitetit. Shkalla zyrtare e papunësisë në zonat rurale, konsiderohet më e ulët se në zonat urbane. Paga mesatare mujore bruto në bujqësi, pylltari dhe peshkim tenton që të arrijë mesataren kombëtare e cila ishte 33,359 lekë në vitin 2020. Prodhimi bujqësor dominohet nga fermat e vogla dhe fermat familjare. 85% e fermave klasifikohen si të vogla. Në periudhën 2020–2022, edhe falë integritit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes, ku mbështetja ndaj naftës ka pasur një rol thelbësor, numri i fermerëve të pajisur me NIPT fermeri është rritur ndjeshëm.

Kështu, në vitin 2021 dhe në muajt e parë të vitit 2022, janë pajisur me NIPT fermeri dyfishi i fermerëve që kanë marrë NIPT fermeri për periudhën 2017–2020. Madhësia mesatare e pandryshuar prej 1.2 ha, e kombinuar me fragmentimin dhe të drejtën e paqartë të pronës janë sfidat kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë. Megjithatë, pronarët e vegjël luajnë rol kritik për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Vështirësitë strukturore të trashëguara të fermave, po mbështeten nga politika publike, të cilat synojnë bashkimin e fermerëve në procesin e tregtimit të produkteve bujqësore.

Qëndrueshmëria e fermës është një nga objektivat e politikave bujqësore. Pragu i qëndrueshmërisë ekonomike të fermës duhet parë si dinamik, në varësi të çmimeve të tregut, kostos së jetesës dhe faktorëve të tjerë, që mundësojnë vazhdimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale. Studimet sektoriale të përgatitura në vitin 2021 tregojnë si madhësim minimale për qëndrueshmërinë ekonomike të fermës njësinë prej 0.20 ha në rastin e serrave, 0.5ha për fermat e agrumeve, 0.90 ha për vreshtat, 1 ha për perimet në fushë dhe pemëtoret dhe 2ha për fermat e ullirit. Megjithatë, një qëndrueshmëri e shëndoshë ekonomike mund të arrihet vetëm në pragje më të larta, pasi fitimi nga fermat të tilla të vogla mund të mos mbulojë nevojat financiare të familjes, dhe në kushtet kur aksesit në rritjen e nivelit të sipërfaqes është i kufizuar, rritja e qëndrueshmërisë mund të prodhohet nga bashkëpunimi midis fermerëve apo dinamizmi i tregut të qiradhënies së tokës.

Analiza e luhatjes së prodhimit të kulturave gjatë viteve 2015–2020 (tabela 3-4) në përgjithësi është e ndërlidhur mirë me sipërfaqet e kultivuara dhe tregon një orientim drejt kulturave më të tregtueshme, si p.sh. perimet (gjithashtu, me një rritje të produktivitetit), bimët aromatikë mjekësore etj. Bujqësia shqiptare po tregon shenja të rëndësishme të hapjes së saj ndaj tregjeve duke udhëzuar nga kulturat për të cilat ekziston një avantazh i qartë krahasues me produktet në tregjet ndërkombëtare. Ulja e prodhimit të disa kulturave specifike, efektiviteti i të cilave lidhet me sisteme prodhimi me sipërfaqeve të mëdha (disa lloje drithërash apo bimësh industriale) tregon një ndryshim pozitiv të sektorit, i cili është tashmë i vetëdijshëm për pikat e tij të forta, si edhe limitet.¹

Kreditimi i ulët nga bankat dhe institucionet e mikrofinancës, interesat e larta të kredive në sektorin e bujqësisë, si dhe mungesa e kolateralit për të garantuar të tilla kredi e kanë zvogëluar në mënyrë të ndjeshme aksesin në financime subjekteve në sektorin e bujqësisë.

Në shtete si Brazili, Ukraina, etj. fermerët e vegjël janë përballur me pamundësinë për t'u kredituar, pasi iu mungonte kolaterali. Kështu në Brazil, që në vitet '60 u miratua koncepti i "premtimit për të paguar" (*Promisory Note*) si mënyrë e financimit të bujqësisë, përpara vjeljes së produktit dhe pas magazinimit të

¹Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 29.6.2022 "Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021/2027", fq.20.

produkteve bujqësore. Fillimisht kjo mënyrë financimi u përdor nga bankat, të cilat mbështeteshin nga qeveria për të financuar fermerët. Me rënien e mbështetjes financiare nga qeveria u desh të gjendeshin alternativa të tjera të financimeve private dhe në vitin 1994 u miratua në Brazil instrumenti i ri “*Cedula de Prodoto Rural*” (CPR) që janë tituj mbi produktin rural, si mënyrë financimi në bujqësi mënyrë e cila solli hov në zhvillimin e bujqësisë në këtë shtet. Po ashtu në Ukrainë një ligj i ngjashëm është miratuar në vitin 2012, bazuar në modelin e sukseshëm të Brazilit dhe si mënyrë për të ndihmuar me financime fermerët e mesëm dhe të vegjël. Rezultati në Ukrainë ishte që në gjashtë vite mbi 3500 fermerë u paisën me mbi 7100 tituj mbi produktet bujqësore dhe tejkaluan mbi 1.7 miliardë dollarë financime.

Si rezultat i takimeve dhe komunikimeve që kemi pasur me grupet e interesuara të furnizuesve të lëndëve të para, të eksportuesve, të fermerëve etj konstatuam se ekziston në terren një marrëdhënie mirëbesimi ku furnizuesit e lëndëve të para u japin fermerëve produktet e tyre pa pagesë me premtimin se pas sezonit të vjeljeve fermeri do të kthejë shumën në të holla furnizuesit ose pagësën e kryen në natyrë përmes produkteve bujqësore që fermeri prodhon/kultivon.

Gjatë takimeve me specialistët në fushën e bujqësisë u konfirmua gjithashtu se tashmë prej kohësh kishte një marrëdhënie me mirëbesim mes fermerit dhe blerësit, të cilët me marrëveshje mes tyre, blerësi i premtton në mënyrë paraprake fermerit blerjen e produkteve bujqësore të ardhshme. Një marrëdhënie kjo e parregulluar ligjërisht e për pasojë shpesh abuzive kundrejt fermerit ku për qëllime përfitimi blerësi mund të mos i qëndrojë fjalës së dhënë lidhur me çmimin e produktit duke hedhur pretendime lidhur me sasinë, cilësinë etj. të produktit bujqësor.

Transformimi me ritme më të shpejta i prodhimit bujqësor, që është i nevojshëm për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme ushqimore kërkon një sektor bujqësor ekonomikisht performues dhe të qëndrueshëm, si edhe një sektor konkurrues të agropërpunimit. Sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore janë, si për të përmirësuar mundësitë e aktivitetit në bujqësi, ashtu edhe për të gjeneruar mundësi të reja, si dhe për të konsoliduar tregjet ekzistuese dhe eksploruar tregje të reja, brenda dhe jashtë vendit për sektorin agrorshqimor.

Gjatë procesit të hartimit të raportit “Për legjislacionin egzistues, praktikat dhe prespektivat për dëftesat tregëtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe të magazinuar në Shqipëri”, u identifikuan edhe gjetjet e sipërcituara. Për realizimin e raportit u bashkëpunua mes ekspertëve të IFC/ EëB Group, gjatë periudhës mars- korrik të vitit 2022. Ndër rekomandimet e raportit ishte edhe hartimi i një kuadri ligjor në fushën e dëftesave tregëtare mbi produktet bujqësore, i akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe hartimi i manualeve të zbatimit të ligjit dhe trajnimi i fermerëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Nevoja për mbështetje të qëndrueshmërisë së fermave kërkohet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, e nxitur kryesisht nga ndryshimet e vazhdueshme të tregjeve ndërkombëtare dhe procesi i stabilizimit të tregjeve të reja për produktet shqiptare, si dhe nga rritja e ngjarjeve të motit ekstrem të nxitura nga klima.

Sfida dhe problematika më e rëndësishme është niveli i ulët i investimeve tek fermerët, kreditimet e ulëta bankare për shkak të mungesës së kolateralit si edhe vlerësimi i sektorit bujqësor si me risk të lartë nga

bankat. Pamjaftushmëria e financimeve ka shkaktuar pamundësi të fermerëve për të ushtruar dhe zgjeruar aktivitetin e tyre. Gjithashtu vakumi ligjor në ofrimin e mbrojtjes dhe përcaktimin përmes një akti ligjor të të drejtave të fermerit gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij tregëtare ka bërë që shpesh fermeri të jetë objekt abuzimi në këtë aspekt.

Shkaqet e këtij problemi janë:

- mungesa e një kapitali financiar fillestar për fermerët, që t'iu mundësojë përballimin e kostove për lëndët e para për kultivimin e tokës;
- mungesa e kolateralit si garanci për kreditë bankare, për shkak se shumë nga fermerët nuk kanë në pronësi as tokë bujqësore apo shtëpi banimi, si dhe shumë nga tokat bujqësore të ndara nuk janë të regjistruara ende në sistemin kadastral, që të mund të përdoren si të tilla për të garantuar kreditë;
- mungesa e një rregullimi ligjor për instrumente alternative financimi, të ndryshme nga kredite bankare, që mundësojnë përdorimin e produkteve bujqësore në prodhim apo të prodhuara e të magazinuara si kolateral dhe sigurimi për qasje në financime si dhe përfitime financiare për fermeret nga shtyrja e marrjes së çmimit të shitjes në një kohë të ardhshme të përshtatshme;
- përqindjet e larta të kredive të ofruara nga bankat apo institucionet e mikrofinancës që nuk përputhen me marzhet e ulëta të fitimit nga aktiviteti bujqësor apo blegtoral;
- keqpërdorimi i mirëbesimit nga ana e blerësit në marrëdhëniet e parregulluara ligjërisht në rastin e blerjes së produktit të ardhshëm bujqësor.

Niveli i investimeve bujqësore në Shqipëri është ende i ulët. Mungesa e aksesit në financime të subjekteve në sektorin e bujqësisë e ka lënë këtë sektor të pamodernizuar, me ferma të vogla dhe jo gjithmonë rentabile, gjë që ka sjellë për pasojë edhe plagë sociale, si lëvizjen e popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit apo në emigracion në shtete më të zhvilluara, duke i lënë të pashfrytëzuara tokat bujqësore në pronësi apo në përdorim. Bujqësia mbetet sektori kryesor i punësimit për fuqinë punëtore. Rreth 52% e të punësuarve ose 500 529 persona të punësuar me kohë të plotë, ishin të angazhuar në sektorin bujqësor (INSTAT, 2013). ndërsa pritet që përmirësimi i përdorimit të tokës do mundësojë punësim shtesë. Kjo tendencë reflekton një sfidë politike shumë të madhe për qeverinë shqiptare. Megjithatë, bujqësia do të mbetet një sektor kryesor punësimi edhe në vitin 2020.

Subjektet e prekura nga ky problem janë fermerët dhe familjet e tyre. Por në mënyrë zinxhir, ky problem prek gjithë sektorin, si:

- agropërpunimin;
- grumbulluesit;
- tregtarët me shumicë e pakicë;
- tregtarët e lëndëve të para;
- rrjetet e supermarketeve;
- konsumatorët.

Transformimi me ritme më të shpejta i prodhimit bujqësor, që është i nevojshëm për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme ushqimore kërkon një sektor bujqësor ekonomikisht performues dhe të qëndrueshëm, si edhe një sektor konkurrues të agropërpunimit. Sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore janë, si për të përmirësuar mundësitë e aktivitetit në bujqësi, ashtu edhe për të gjeneruar mundësi të reja, si dhe për të konsoliduar tregjet ekzistuese dhe eksploruar tregje të reja, brenda dhe jashtë vendit për sektorin agroushqimor. Me synimin e rritjes së eksporteve, do të promovohet veçanërisht rritja e konkurrueshmërisë, duke përmirësuar nivelin e mekanizimit të fermave, duke rritur sipërfaqet e srrave, të pemëve frutore

intensive. diversifikimi i produkteve bujqësore të kultivuara dhe shtimi i sipërfaqeve, të cilat kanë vlerë më të lartë të shtuar për operatorët e sektorit dhe ose kalojnë nëpërmjet përpunimit, si dhe nëpërmjet shtimit të blegtorisë së imët. Shumica e fermave janë të përziera dhe karakterizohen nga parcela të vogla dhe të fragmentuara.

Sipërfaqja e tokës bujqësore e pashfrytëzuar llogaritet në rreth 100,000 ha, e cila përfaqësohet kryesisht nga kategoria e tokave të pandara, aktualisht në administrim të bashkive. Meqenëse të ardhurat e fermave, ndër të tjera, janë të lidhura drejtpërdrejt edhe me madhësinë e fermës, rrjedhimisht madhësitë minimale të një ferme ekonomisht të qëndrueshme është e rëndësishme të vijojnë të jenë një kriter që duhet të merret në konsideratë në procesin e hartimit të politikave mbështetëse në të ardhshmen, duke u bazuar edhe në përvojën e deritanishme me skemat e mbështetëse kombëtare, por edhe ato të zbatuara në kuadër të IPARD. Nevoja për të konsoliduar prodhimin nga njëra anë dhe miratuar politikat e duhura, përmes të cilave të përfshihen një numër sa më të madh fermerësh, duhet të bëjnë të mundur që edhe në të ardhmen masat direkte të mbështeten në forcimin e bashkëpunimit midis operatorëve ekonomikë.

Çështjet e pronësisë së tokës (kryesisht të lidhura regjistrimin e titujve të pronësisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie) njihen si një pengesë e rëndësishme në procesin e konsolidimit të fermave, që ndikon në arritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të tyre.

Ekonomia shqiptare pritet të rritet me ritme më të ulëta në vitet në vijim, duke qenë se është prekur nga kriza ekonomike globale. Forca e punës është një faktor kyç për produktivitetin. Të dhënat e ILOSTAT-it për vitin 2019 tregojnë se bujqësia angazhon 460,600 njësi vjetore pune (NJVP), që do të thotë 36.4% nga fuqia totale e punës janë të punësuar në bujqësi. Aktualisht, kostoja e fuqisë punëtore në Shqipëri është 10 herë më e ulët se mesatarja e BE-së. Kështu, kostot e fuqisë punëtore mund të konsiderohen të lira. Produktiviteti i fuqisë punëtore në sektorin e bujqësisë ka ardhur në rritje të vazhdueshme, duke llogaritur 5,680 euro për çdo person që punonte në bujqësi në vitin 2020. Bujqësia po humbet gradualisht fuqinë punëtore, si pasojë e rritjes së nivelit të mekanizimit në sektor, që e bën të panevojshëm numrin e lartë të punëtorëve, veçanërisht në kushtet e fermave të specializuara. Siç tregohet në anketat e INSTAT-it (p.sh. anketa tremujore e forcës së punës të kryer nga INSTAT-i për tremujorin e tretë 2020 krahasuar me tremujorin e tretë 2019), se norma vjetore e rritjes së punësimit në bujqësi ishte me minus -3.7 %, vlerë kjo më e ulët në krahasim me të gjithë sektorët e tjerë ekonomikë. Fermerët shqiptarë kanë akoma pak fuqi negociuese. Çmimet e inputeve janë rrallë të negociueshme dhe, duke mos qenë pjesë e ndonjë organizate bujqësore, formimi i çmimeve është kryesisht atribut i grumbulluesve, shitësve me shumicë dhe i përpunuesve vendës. Marrëveshjet e zinxhirit të furnizimit ndërmjet blerësve dhe fermerëve/kontratit e furnizimit nënshkruhen rrallë. Sektorët me orientim eksportin, si prodhimi i perimeve në serra, janë më të prirur për t'u ngritur/bashkuar në organizata prodhuese, ndërsa për sektorin e blegtorisë kjo mbetet sfida më e madhe.

Niveli i investimeve bujqësore në Shqipëri është ende i ulët. Gjatë vitit 2011 në sektorin bujqësor janë investuar minimalisht 20 milionë euro (këtu përfshihen investime private si edhe financimi i skemave mbështetëse publike), shifër e cila është një koeficient ende i ulët investimesh. Raporti mesatar vjetor midis vlerës së prodhimit bujqësor në 10SHRA dhe nivelit vjetor të investimeve (i shprehur me formimin bruto të kapitalit fiks -FBKF) ka qenë 6,4 në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2012.

Fermerët e rinj janë veçanërisht të rrezikuar nga papunësia dhe nga një perceptim mbi mungesën e jetës sociale në zonat rurale. Prandaj, ata janë veçanërisht të ekspozuar ndaj migrimit në qytete brenda vendit, por dhe jashtë vendit. Kjo nuk është një veçori shqiptare, por që haset gjerësisht. Fermerët e rinj kanë një interes më të madh në adoptimin e teknologjive të reja dhe praktikave miqësore me mjedisin.

Nëse sektori bujqësor në Shqipëri do të duhet të konkurrojë në mënyrë të suksesshme, pritet që ai të rrisë investimet në vitet në vijim për të vazhduar me rritjen e sektorit dhe të produktivitetit të punës me të njëjtin ritëm ose me ritëm edhe më të shpejtë sesa ai i konkurrentëve të vetë kryesorë. Kjo gjë do të kërkojë një rritje të madhe në investimet vjetore nga niveli i kohëve të fundit prej 20 milionë euro,¹³ deri në vitin 2020.

Kjo ndërhyrje do të paraqesë kushtet e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe mbështetjen për investime në sektor në mënyrë që aktorët ta arrijnë këtë objektiv. E njëjta sfidë ekziston edhe për sektorin e përpunimit agroushqimor-investime të konsiderueshme janë të nevojshme për të bërë të mundur rritjen e konkurrueshmërisë. Pra propozimi që parashikon dy instrumentet financiare përkatëse është rruga e duhur për t'i dhënë zgjidhje pjesës më të madhe të problemeve të parashtruara deri më tani.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Sot, bujqësia është shëndërruar në një prej motorëve kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Shqipëria do të shtojë prodhimin, do të rrisë cilësinë dhe certifikimet standarte duke u bërë një aktor gjithmonë e më i rëndësishëm i eksporteve bujqësore. Bujqësia bashkë me investimet në infrastrukturë dhe shërbimet në fshat do të sigurojë mundësinë për të ndërtuar një jetë me mirëqenie në fshtain shqiptar.²

Lehtësimi i aksesit në kredi është një nga synimet e sektorit të bujqësisë në kuadrin e politikave afatgjata. Sektori bankar duhet të zhvillojë produkte specifike për sektorin e bujqësisë. Nevoja për instrumente financiare në bujqësi është jashtëzakonisht e lartë dhe duhet të vazhdojë të përfshijë skemat e garancisë, si për akses më të mirë në kredi, ashtu edhe të portofolit të ndarjes së rrezikut të huave, të cilat reduktojnë nevojën për kolateral, por edhe normat e interesit. Në rastin e fermerëve të rinj duhen menduar skema të veçanta mbështetëse për të shmangur barrën e financimit paraprak dhe atë të bashkëfinancimit të investimeve.

Rrjedhimisht, nevojitet inkurajimi i fermerëve të rinj edhe me mjete të tjera për të ngritur një biznes në bujqësi, përveç diferencimit me pikë në klasifikimin për grande. Kjo, për sa kohë që vetëm një numër shumë i kufizuar i të rinjve kanë aktualisht akses në grande ose janë në gjendje të përdorin grande si rrjedhojë e kushtit të financimit paraprak dhe vetëm pjesërisht të faturave (shpenzimeve) të rimbursueshme. Gjithashtu, është e nevojshme të ketë mbështetje plotësuese të të ardhurave për fermerët e rinj. Skema të veçanta të mbështetjes me pagesa paradhënie të bazuara në planet e dorëzuara të biznesit janë më të përshtatshme për fermerët e rinj. Duhet të mbahet në konsideratë mundësia e tërheqjes së të rinjve të diplomuar nga universitetet bujqësore.

Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare po punon se si të rrisë aksesin në financime për të gjithë sektorët e ekonomisë, veçanërisht për sektorin e bujqësisë. Në këtë aspekt, Qeveria ndër të tjera, ka punuar dokumente strategjike përmes të cilave synon të përcaktojë objektiva, të formojë

²Programi Qeverisës 2021-2025. Fq.7https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

kuadrin institucional të politikave dhe instrumenteve që mundësojnë arritjen e këtyre objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë si dhe përmbushjen e agazhimeve në kuadër të procesit të përafrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Një dokument i tillë është edhe “Strategjia bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021-2027” i cili u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 460, datë 29.6.2022. ky dokument u hartua në kuadër të synimeve të Qeverisë për të përcaktuar kuadrin strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor në shtatë vjetët, 2021- 2027, për përmbushjen e nevojave reale të aktorëve të grupeve të interesit si mbështetje për përballimin e sfidave agatmesme dhe afatgjata lidhur me sigurimin e ushqimit, rritjes së të ardhurave, efektet e ndryshimit të klimës, ruajtjen e biodiversitetit, për të zhvilluar dhe bërë më konkurruese ekonominë e familjeve në zonat rurale, bazuar në politika që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin eficient të inpueteve bujqësore dhe peshkimit, si dhe njohurive bujqësore dhe inovacionit.

Referuar pikës 1.3, “Objektivat e Qeverisë Shqiptare në Programin e periudhës 2021- 2025”, Qeveria me theks të vecantë rritjen e aktiviteteve ekonomike, parashikon arritjen e objektivave për zhvillimin bujqësor dhe rural nëpërmjet:

- Përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetës në zonat rural dhe diversifikimi i hapësirave dhe i mundësive *për aktivitete ekonomike*.
- Promovim të eliminimit të dallimeve në standartet e jetesës nëpërmjet zonave rurale dhe atyre urbane, përmes investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën publike rurale në shërbim të aktiviteteve ekonomike të aktorëve në bujqësi, si p.sh nëpërmjet investimeve në ujësjellës dhe në kanalizime, furnizim me energji elektrike, shënetësi dhe arsim, infrastrukturë rrugore dhe përmirësim të teknologjisë dhe të njohurive mbi teknologjitë e avancuar të prodhimit dhe të mbështetjes për ndërveprim më të madh ekonomik dhe social nëpërmjet aktorëve.

Në vijim politikat dhe objektivat e përgjithshme të SBZHRP 2021–2027 përmbajnë tri fusha politikash dhe objektiva ndërsektoriale, sic janë: *Politika 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe i zonave rurale e cila përmban tre objektiva të përgjithshëm, si vijon: 1. Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor: 2. Përmirësimi i efektshmërisë dhe prodhimit të qëndrueshëm në fermë, rritja e orientimit drejt tregut të sektorit të agropërpunimit ushqimor, harmonizimi në mënyrë progresive i tij me standardet e BE-së, gjë që do të japë një përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm³.*

Pasi janë analizuar modelet më të mira të financimit të sektorit të bujqësisë në shtete me bujqësi të zhvilluar, si dhe marrëdhëniet faktike në vendin tonë mes fermerëve dhe tregtarëve të lëndëve të para, agropërpunuesve apo pikave të grumbullimit, janë identifikuar instrumentet financiare, që do të bëjnë rregullimin juridik përmes përcaktimeve ligjore për këto marrëdhënie, duke rritur garancitë për palët në proces.

Ofrimi i garancisë për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë të sektorit, produkte më të sigurta dhe të certifikuara. Vendosja e rregullave për zhvillimin e veprimtarisë së tregëtimit të fermerit për produktet bujqësore, mbrojtja e të drejtave të fermerit por edhe të konsumatorit, rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve të përfshirë në këtë fushë veprimtarie si dhe çdo subjekt tjetër të angazhuar në fushën e financimit të bujqësisë dhe tregëtisë së produkteve bujqësore.

³Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021/2027”, fq.18.

Numri i fermave/familjeve bujqësore ka rënë me 4% krahasuar me vitin 2007 duke arritur në 350 916 ferma në vitin 2012. Zonat rurale të Shqipërisë karakterizohen nga një ristrukturim gradual ekonomik dhe nga ndryshime të shpejta demografike. Përqindja e popullsisë rurale ka rënë vazhdimisht nga 42,57% në vitin 2015 në 38,89% në vitin 2019, e shkaktuar nga migrimi jashtë vendit dhe nga nivelet përgjithësisht më të ulëta të lindjeve. Emigrantët brenda vendit përthithen kryesisht nga zonat urbane, pasi shkalla e urbanizimit po rritet pavarësisht nga një rënie e përgjithshme e popullsisë. Parashikimet tregojnë se popullsia shqiptare do të ulet me 100,000 njerëz në rreth 2.75 milionë në vitin 2031 krahasuar me vitin 2020.

Infrastruktura financiare në zonat rurale është në zhvillim. Pavarësisht se në Shqipëri operojnë 16 banka tregëtare dhe më shumë së njëqind institucione të tjera financiare, ato janë më pak të pranishme në zonat rurale dhe të thella. Sondazhet tregojnë se vetëm 10% e banorëve ruralë janë të prirur të përdorinshërbimet bankare dhe pjesa e përgjithshme e kredisë për bujqësinë në të gjithë huadhënien është afërsisht 1,7–1,9%. Kjo politike e re që propozohet, synon të ofrojë gjithashtu kuadrin e nevojshëm ligjor dhe mbështetjen e investimeve të operatorëve për të arritur objektivat. Rezulton se politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural kanë kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social të bujqësisë dhe të komuniteteve rurale. Krijimi i biznesit rural, modernizimi dhe diversifikimi i të ardhurave nga ferma sjellin aktivitete ekonomik sidomos në zonat rurale, por edhe jashtë sektorit bujqësor. Kjo është thelbësore nga këndvështrimi i rritjes së përqindjes së fermerëve që punojnë në fermë me kohë të pjeshshme, si edhe i ndryshimit strukturor në sektorin e bujqësor, i cili pritet të rritet në vitet e ardhshme.

Qeveria synon të rrisë aksesin në financime për fermerët pa lënë mënjanë dhe të gjithë aktorët dhe subjektet e tjerë të përfshirë në sektorin e bujqësisë. Të ofrojë forcimin dhe mbrojtjen ligjore për fermerin gjatë ushtrimit të të drejtave të tij në trëgetimin e produkteve bujqësore. Zhvillimi bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm edhe për sa i përket përmirësimit të standardit të jetesës dhe zbutjes së varfërisë.

Prodhimi bujqësor dominohet nga fermat e vogla dhe fermat familjare. 85% e fermave klasifikohen si të vogla. Në periudhën 2020-2022, edhe falë integritit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes, ku për shkak të mbështetjes së dhënë nga MBZHR përmes politikave të saj është rritur ndjeshëm numri i fermëve të paisur me NIPT fermeri. Kështu në vitin 2021 dhe në muajt e parë të vitit 2022, janë pajisur me NIPT fermeri dyfishi i fermerëve që kanë marrë NIPT fermeri për periudhën 2017-2020. Megjithatë, pronarët e vegjël luajnë rol kritik për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme. Në këtë aspekt miratimi i kësaj nisme ligjore do vijojë të stimulojë fermerin të paiset me NIPT fermeri pasi subjekt në qëndër të kësaj nisme është vetëm fermerii paisur me NIPT, duke vijuar kështu të mbështesë linjën e strategjisë së ministrisë në përpjekjet e saj për formalizimin dhe konsolidimin e profilit të fermerit.

Ndërrhyrja dhe propozimi i kësaj nisme është i nevojshëm për arsye të rregullimit të tregëtimit të prodhimit si dhe mbështetjen e fermerit për të marrë financime më të mëdha bankare. Garantimin për një rregullim bashkëkohor, pa kosto për sektorin privat, një marrëdhënieje juridike të digjitalizuar për palët, me garancitë përkatëse ligjore.

Kjo ndërhyrje sjell një hov cilësor në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, një nga sektorët më të rëndësishëm strategjik të qeverisë, duke i lidhur njerëzit me shumë me tokën e duke shmangur shpopullimin, duke e bërë rentabël sektorin, si dhe duke bërë të mundur përmirësimet teknologjike dhe modernizimin e sektorit, në mënyrë që fermerët, të cilët merren me bujqësi, si dhe të gjithë të punësuarit në të gjithë zinxhirin e vlerave, të sigurojnë të ardhura të kënaqshme dhe më shumë mirëqënie. Zhvillimi bujqësor është gjithashtu i

rëndësishëm edhe për sa i përket përmirësimit të standardit të jetesës. Rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standardin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta dhe të sigurta.

Që nga muaji mars 2022 e në vijim janë zhvilluar takime dhe komunikime intensive me subjektet e përfshira në sektorin e bujqësisë për të analizuar në detaje problemet e tyre në lidhje me financimin, praktikat më të mira ndërkombëtare për financimin e bujqësisë dhe sesi mund të bëhen pjesë e legjislacionit tonë instrumentet financiare të testuara në shtetet e tjera për të zhvilluar më tej bujqësinë.

Qëllimi final që ministria synon të arrijë përmes propozimit të kësaj politike të re është garantimi i rritjes së financimit të fermerit dhe rritja e prodhimit bujqësor, i cili jo vetëm që zhvillon ekonominë dhe ul papunësinë, por mundëson uljen e çmimeve të produkteve kryesore jetike që konsumohen nga popullata, si dhe ul varësinë e vendit nga importet. Promovimi i zhvillimit lokal nëpërmjet përmirësimit të mundësive të punësimit dhe të zhvillimit të biznesit brenda dhe jashtë fermës bujqësore, si dhe përmes iniciativave për zhvillim të territorit të udhëhequra nga komuniteti, në të njëjtën kohë zhvillimi kapaciteteve administrative dhe institucionale, bashkëpunimi i aktorëve, inovacioni dhe digjitalizimi.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat konsistojnë si më poshtë vijojnë:

- Rritja e nivelit të financimit për sektorin bujqësor dhe sigurimi i mjeteve alternative të financimit, brenda vitit të pestë të zbatimit të kuadrit ligjor të ri; Pajisja e fermerëve me deftësën tregëtare, me qëllim përfitimin e kredive bankare më përqindje më të ulët brenda një afati 3 vjeçar.
- Rregullimi ligjor i marrëdhënieve tregëtare nëpërmjet përmirësimit të sistemit të gjurmshmerisë së produkteve bujqësore nga ferma në tavolinë në të njëjtën kohë brenda 3 viteve.
- Sigurimi i pagesave të shpejta dhe të drejta për fermerin për produktin bujqësor të ardhshëm dhe atë të magazinuar.
- Krijimi i një sistemi kolaterali biologjik nëpërmjet produktit bujqësor të ardhshëm apo atij të magazinuar.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionin e status quo-së.

Opsioni i parë është mos ndërhyrja e qeverisë dhe vijimi në të njëjtat kushte duke pritur që situata të vetërregullohet. Ruajtja e e status-quo-së con në mos dhënien zgjidhje të problemeve të hasura në praktikë. Vijimi i situatës siç është i ka dekurajuar fermerët të kultivojnë, për shkak të kostove të larta të prodhimit dhe mungesës së mjeteve të nevojshme financiare, pamundësisë për të investuar në makineri dhe teknologji, vështirësi në qasjen në tregje me sasinë dhe çilesinë e kërkuar, që rrezikon shitjen e produkteve. Ky sektor duhet zhvilluar jo vetëm si një nga sektorët kryesorë të ekonomisë, por edhe si mbështetje e madhe sociale për popullsinë rurale për të evituar emigracionin, kur kanë mundësi të zhvillojnë bujqësinë. Përzgjedhja e

këtij opsioni nuk paraqet kosto të shtuara, por në të njëjtën kohë nuk zgjidh problematikat e evidentuara më lart.

Opsioni 1: Hartimi i një ligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”

Në vetvete ky opsion sjell risi në vendin tonë. Parashikimi i dy instrumenteve të reja financiare në dobi të fermerit, si dhe ofrimin e mbrojtjes së këtij të fundit nga abuzimet e mundshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga ai që nuk kanë ekzistuar më parë në sektorin e bujqësisë si dhe duke krijuar ligjërisht kolateralin biologjik, pra prodhimin bujqësor të ardhshëm apo të magazinuar, si kolateral, duke krijuar kështu mundësinë për financim të të gjithë sektorit të bujqësisë nga një pluralitet subjektsh të përfshira, si: banka, institucione mikrofinance, tregtarë lëndësh të para, agropërpunes, zinxhirë supermarketesh, etj. Duke qenë, se këto instrumenta financiar aktualisht mungojnë në tregun shqiptar dhe nuk rregullohen me asnjë akt tjetër ligjor, konsiderojmë se opsioni 1 është një opsion i vlefshëm për rregullimin e situatës juridike aktuale të fermerëve.

Pikërisht ky opsion, si propozim i një politike risi në Shqipëri, jo vetëm sjell në vendin tonë tre instrumente financiare që mobilizojnë financimin nga sektori privat i bujqësisë, por bën një rregullim të plotë, të një marrëdhënie faktike, të parregulluar përmes ligjit deri tani, mes subjekteve të përfshira në sektorin e bujqësisë.

Opsioni 2: Rishikimi i bazës ligjore ekzistuese- ky opsion do të thotë rishikimin e bazës ligjore ekzistuese por në rastin tonë propozimet që sjell ky projektligj, dëftesat tregëtare, si instrumente financiare në bujqësi janë risi për vëndin tonë dhe nuk janë parashikuar më parë me akte të tjera ligjore. Masat e marra nga Qeveria për rritjen e mënyrave të financimit të fermerëve janë të shumata përmëndim këtu skemat mbështetëse, apo mbështetjen nga IPARD. Megjithatë ministria dhe Qeveria janë gjithmonë në kërkim të opsioneve të reja në mbështetje të fermerit. Kjo nismë ligjore synon që të ndihmojë fermerin në një tjetër dimension, i cili nuk është parashikuar më parë nga asnjë akt ligjor apo nënligjor. Pra është vizioni i përdorimit të produktit bujqësor si kolateral, rregullimin e pagesave në një treg që egziston në mënyrë informale etj. Nëpërmjet këtij opsioni, do të nevojitej ndërhyrja në shumë akte rregullatore ekzistuese, e cila do ta bënte shumë të vështirë kuptueshmërinë e akteve ku do të kryheshin ndërhyrjet, por do të humbiste edhe qartësia juridike. Gjithashtu, futja e një instrumenti të tillë kërkon një bazë ligjore më vete, duke qene se edhe zbatueshmëria e një politike të tillë do të kërkojë disa kushte të vecanta dhe të mirëpërcaktuara. Opsioni 2 gjithashtu, paraqet me shume kosto duke qene se do të prekeshin disa akte ligjore/nënligjore njëkohësisht, si dhe do të kërkonte më shumë kohë për realizimin e tij.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga kjo nismë janë:

- Fermerët
- Tregtarët e lëndëve të para në bujqësi (fara, fidane e te tjera te ngjashme)
- Magazinuesit e produkteve bujqësore/ Pikat e grumbullimit/ Tregtarët me shumicë Eksportuesit
- Bankat dhe institucionet e tjera të mikrofinancës
- Agropërpunuesit/ Rrjetet e supermarketeve/ Tregtarët me pakicë
- Qeveria
- Punëmarrësit
- Komunitetet e banorëve në zonat rurale
- Përmblyesit privatë
- Institucionet financiare dhe mikrofinanciare
- Furnizuesit e lëndëve të para

Ndikimet për secilin grup të prekur përfshijnë:

- **Fermerët**- do të kenë mundësi për më shumë financime për lëndët e para, për të garantuar shitjen e produktit bujqësor me çmimin më të mirë të mundshëm, si dhe të zhvillojnë një bujqësi më të zgjeruar dhe që siguron të ardhura të mira për gjithë familjen;
- **Tregtarët e lëndëve të para në bujqësi**- kanë mundësi të rrisin numrin e blerësve, të garantohen për pagimin e cmimit nëpërmjet një kolaterali biologjik (produkti bujqësor i ardhshëm);
- **Magazinuesit e produkteve bujqësore/ Pikat e grumbullimit/ Tregtarët me shumicë/ Eksportuesit**- shoqëritë që zhvillojnë këto veprimtari kanë mundësi të jenë të garantuara për pagimin e shpërblimit të magazinimit apo te ofrimit nga ana e fermerit te produktit ne sasine dhe cilesine e kerkuar si dhe ne kohen e rene dakord, duke pasur si garanci kolateralin biologjik.
- **Bankat dhe institucionet e tjera të mikrofinancës**- kanë mundësi të rrisin portofolin e kredive për fermerët, duke u garantuar me kolateralin biologjik e kësisoj duke zbritur përqindjet e interesit të kredive;
- **Agropërpunuesit/ Rrjetet e supermarketeve/ Tregtarët e vegjël** - kanë mundësi të kontraktajnë që në fillim produktin bujqësor të ardhshëm, sipas specifikimeve sasiore dhe cilësore, që atyre iu duhen dhe me një çmim të arsyeshëm, duke pasur mundësinë për të ushtruar kontrollet përkatëse mbi cilësinë e produktit, deri në pjekjen/ vjeljen e tij;
- **Qeveria**- ka mundësi të rrisë të ardhurat në buxhetin e shtetit për shkak të intensifikimit të aktiviteteve bujqësore, si dhe të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të rritjes së numrit të të punësuarve në bujqësi;

- **Punëmarrësit-** kanë mundësi të kenë më shumë oferta pune në sektorin bujqësor përgjatë gjithë vitit dhe me pagë të garantuar, pa patur nevojë për punësim shtesë sezonal në shtetet fqinjë;
- **Komunitetet e banorëve në zonat rurale-** intensifikimi, zgjerimi dhe modernizimi i bujqësisë përforcon ofertën ekonomike dhe sociale në ato zona, duke sjellë një jetesë më të mirë për banorët ruralë, duke u ofruar të rinjve një mundësi më tepër punësimi dhe një ofertë ekonomike tërheqëse, dhe kështu edhe shërbime sociale më të mira për të gjitha moshat.
- **Përmbaruesit privatë-** një risi e ligjit është edhe përkufizimi i deftesës tregtare si titull i ekzekutueshëm, i cili përfshin dhe zgjeron fushën e veprimtarisë së përmbaruesve privatë tashmë edhe në fushën e bujqësisë.
- Dy llojet e dëftesat tregtare, mbi produktin bujqësor, të ardhshëm dhe atë të magazinuar janë instrumente financiare, si titujtë transferueshëm, në kuptimin e ligjit nr. 62/ 2020 “Për tregjet e kapitalit”. Ku e para përcakton detyrimin e pakushtëzuar të debitorit për t’i lëvruar kreditorit, produktin bujqësor ose pagesën e siguruar nga një produkt bujqësor, e regjistruar në regjistrin elektronik, me barrë siguroese dhe përbën titull ekzekutiv. Ndërsa e dyta përbën titull ekzekutiv, është e regjistruar në regjistrin elektronik, me barrë siguroese, kur përdoret si mjet për të garantuar përmbushjen e një detyrimi, të marrë nga debitori.
- **Institucionet financiare dhe mikrofinanciare-** ligji synon që ti japë një rëndësi të një niveli tjetër produktit bujqësor, produktit bujqësor të ardhshëm dhe produktit bujqësor të magazinuar duke lëshuar deftesa tregtare për secilën kategori në funksion të mbështetjes së fermerit gjatë kështjës së tij për kreditim në banka.
- **Furnizuesit e lëndëve të para-** janë në grupin të cilët preken nga zbatimi i këtij ligji në të ardhmen pasi janë ata të cilët përmes deftesave tregtare do të forcojnë, formalizojnë dhe sigurojnë një marrëdhënie tregtare duke rritur burimin dhe të qarkullimit të financimit.

Ndikim kryesor i drejtëpërdrejtë për të gjitha grupet e prekura është rritja e të ardhurave të tyre. Konkretisht fermerët garantojnë të ardhurat e tyre nga bujqësia, tregtarët e lëndëve të para i shesin më shpejt mallrat dhe i arkëtojnë më shpejt të hyrat, po ashtu agropërpunimi dhe rrjetet e supermarketeve garantojnë produkte më cilësore, me çmime më të arsyeshme, Shteti arkëton më shumë të hyra nga intensifikimi i bujqësisë, komunitetet e banorëve në zonat rurale sigurojnë një jetë më të mirë, e po ashtu punëmarrësit garantojnë punë në bujqësi për gjatë gjithë vitit.

Disa nga grupet e prekura kanë përfitime të drejtëpërdrejta si vijon:

- **Fermerët-**sigurojnë financime të shpejta, alternative dhe me kosto të ulët, pa pasur nevojën të lenë si kolateral tokën, banesën, mjetet bujqësore, si dhe sigurojnë shitjen paraprake të produkteve bujqësore dhe me çmim të volitshëm, rritje të investimeve në bizneset bujqësore, rritja e aktivitetit bujqësor, sigurimi juridik/kontraktor i marrëdhënieve të tyre tregtare, rritja e cilësisë së produkteve;
- **Tregtarët e lëndëve të para në bujqësi-** kanë mundësinë të përfshihen në zinxhirin e financimit të fermerëve në mënyrë të sigurt për arkëtimin e të ardhurave nga shitja e lëndës së parë, si dhe mundësi të rrisin më tej volumin e shitjeve të tyre, rritja e të ardhurave si pasojë e rritjes së volumit të shitjeve, garantimi i sigurisë juridike për marrëdhëniet tregtare ndërmjet tyre dhe fermerëve
- **Magazinuesit e produkteve u** garantohet pagesa për shërbimin e kryer;
- **Bankat dhe institucionet e tjera të mikrofinancës** mund të rrisin portofolin e kredive të tyre në fushën e bujqësisë, duke qenë të siguruar me kolateralin përkatës që herë është produkti bujqësor i ardhshëm dhe herë produkti bujqësor i magazinuar;

- **Agropërpunuesit/ Pikat e grumbullimit/ Tregtarët me shumicë/ Eksportuesit bujqësorë/ Rrjetet e supermarketeve/ Tregtarët e vegjël** kanë mundësi dhe më shumë siguri ligjërish, që të porosisin produktet bujqësore, që atyre iu duhen si inpute, me karakteristikat e paracaktuara sasiore dhe cilësore, si dhe me një çmim më të favorshëm për ta.
- **Qeveria** rrit punësimin në sektorin e bujqësisë dhe më gjerë, siguron më shumë të ardhura në buxhetin e saj nga rritja e prodhimit bujqësor dhe më shumë të hyra si kontribute për skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, garanton më tej produkte bujqësore cilësore, me procese të pajtueshme me mjedisin dhe të shëndetshme për popullatën e gjerë. Rritja e investimeve në sektorin bujqësor, nxitja e investitorëve të huaj ose vendas për të investuar në tregun shqiptar, rritja e nivelit të eksporteve për produktin vendas që con për rrjedhojë edhe në rritjen e nivelit ekonomik të vendit tonë.
- **Punëmarrësit** më shumë vende pune do të hapen jo vetëm në sektorin e bujqësisë, por edhe në atë të agropërpunimit;
- **Komunitetet e banorëve në zonat rurale**, tokat bujqësore, të cilat ata i kanë në pronësi apo përdorim do të mund t'i kultivojnë vetë, ose t'i japin me qira me këtë qëllim përdorimi, duke rritur kështu të ardhurat e tyre vjetore nga kjo pasuri e paluajtshme.

Nisma synon të rrisë madhësinë e fermave, për pasojë edhe të ndërmarrjeve që merren me agropërpunim. Pra projektet janë që të ketë një rritje të ndjeshme të numrit, si dhe të aktiviteteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekzistuese.

Grupet e prekura dhe gjithë popullata duke u financuar dhe kontrolluar më mirë sektori i bujqësisë sigurojnë një ushqim më cilësor, të kontrolluar dhe me çmime të përballueshme.

Ndërhyrja synon t'u mundësojë akses të njëjtë në financime të gjitha subjekteve të përfshira në sektorin bujqësor, kështu konkurrenca do të jetë më e madhe qoftë mes subjekteve prodhuese e tregtuese vendase, ashtu dhe me subjektet importuese duke bërë që në mënyrë të drejtëpërdrejtë të ndikojë në rritjen e cilësisë së produkteve të ofruara për publikun.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik: Për këtë projektligj identifikohen kosto që ngarkojnë buxhetin e shtetit dhe që përfaqësojnë kostot e mbulimit të shpenzimeve të personelit për krijimin e sektorit përkatës në ministri (përafërsisht 5.2 milion lekë në vit), si dhe kostot e mirëmbajtjes së sistemit, pas vitit të tretë, rreth 6 milion lekë në vit.

- ✓ Kosto mujore për krijimin e një sektori të ri me strukturë minimale 1+2, (një përgjegjës sektori, e dy specialist), me kosto të përafërt 368 mijë lekë page mujore (paga mesatare mujore e një përgjegjësi sektori në Ministri prej 140 mijë lekë në muaj dhe për dy specialiste me pagaë mujore mesatare 114 mijë lekë). Kosto mesatare vjetore do të jetë e përbërë nga kosto mujore 368,000 lekë shumëzuar me 12 muaj. Pra kosto vjetore rezulton në vlerën 4,416,000 lekë sa i takon vetëm kostove për pagat., K
- ✓ esaj vlere do t'i shtohet dhe detyrimi për sigurime shoqërore, për 12 muaj, e cila rezulton në një vlerë prej 784,000 lekë për 1 vit. (Vlera epagave shumëzuar me kontributin 16.7%).
- ✓ Pra në total, kostot për paga e sigurime shoqërore, për këtë strukturë të re (përlllogaritur si shpenzime vjetore) rezultojnë në vlerën e përafërt prej 5,200,000 lekë.
- ✓ Kostot për mirëmbajtjen e sistemit elektronik përlllogariten të jenë përafërsisht rreth 500,000 lekë në muaj dhe për 12 muaj kjo kosto mirëmbajtje vjetore do të jetë rreth 6,000,000 lekë. Sqarojme se për tre vitet e para këto kosto mirëmbajtje mbulohen nga SECO e jo buxheti i shtetit.
- ✓

Kosto e drejtëpërdrejtë ekonomike janë edhe krijimi i regjistrit të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore në platformën e-Albania, shpenzimet për këtë janë marrë përsipër të mbështeten nga projekti SECO (Sekretariati Ekonomik i Zvicrës)

s) për një periudhë 3 vjecare nga momenti i krijimit dhe funksionimit të tyre.

Kostot e drejtëpërdrejta për sektorin privat: Nuk identifikohen kosto në sektorin privat me miratimin e këtij projektligji, pasi edhe lëshimi i dëftesave tregtare online, nëpërmjet modulit të dedikuar në platformën e-Albania do të jetë pa pagesë.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat- Fermerët kanë mundësi të financohen menjëherë para se të fillojnë kultivimin e produkteve bujqësore dhe me këtë mekanizëm shpeshherë të kenë të garantuar edhe shitjen e tyre. Po ashtu fermerët kanë mundësi, që ta shtyjnë shitjen e produkteve bujqësore në një moment të dytë, kur çmimet në treg të jenë më të larta dhe duke përdorur instrumentin financiar të dëftesave tregtare mbi produktin e magazinuar, të përfitojnë financime nga bankat apo institucionet e tjera.

Përfitimet ekonomike për sektorin publik- Duke u rritur të ardhurat në sektorin e bujqësisë edhe buxheti i shtetit përfiton më shumë të ardhura nga ky sektor, rritet numri i të punësuarve, si dhe të hyrat në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Ndikimi social i drejtëpërdrejtë- Rritja e punësimit si dhe rritja e prodhimit bujqësor në fshat dhe në sektorin e agropërpunimit. Parashikimi ligjor i këtyre instrumenteve financiare në vendet ku aplikohet ligji ka dhënë hov bujqësisë. Në këtë aspekt pritshmëritë e rritjes së eksportit të produkteve bujqësore të vëndit tonë janë të larta. Rritja e cilësisë së jetesës në zonat rurale, rritja e aktivitetit ekonomik dhe social në fshat, popullimi i zonave rurale dhe krijimi i kushteve optimale për rikthimin e emigrantëve duke krijuar një mjedis të volitshëm ekonomik.

Ndikim jo të drejtëpërdrejtë- nëpërmjet këtij ligji parashikohet të aplikohen çmime më të arsyeshme për konsumatorin, si dhe produkte bujqësore më të kontrolluara dhe më cilësore.. Rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standartin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta.

Ndikimi në mjedis- Projektligji synon që të rrisë interesin e fermerëve për ta kultivuar tokën bujqësore dhe për të mos e përdorur për qëllime të tjera jo-bujqësore ç'ka ka sjellë pakësim të sipërfaqes të kultivuar dhe të kultivueshme. Duke i nxitur fermerët të zhvillojnë një bujqësi më intensive, të standartizuar, të shëndetshme ku vec të tjerave synohet edhe ruajtja e biodiversitetit në zonat rurale.

Konkluzionet tona janë të bazuara në gjendjen reale të sektorit të bujqësisë në vend dhe të shembujve nga shtetet me bujqësi të zhvilluar, duke marrë eksperiencën më të mirë prej tyre, duke evituar problemet fillestare që ata kanë konstatuar. Ka pritshmëri që i njëjti mekanizëm do të funksionojë edhe në sektorin tonë bujqësor.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Siç e kemi shpjeguar edhe më lart janë identifikuar tre opsione, si më poshtë vijojnë:

- Opsioni 0 (*status quo*): Mos ndërhyrja me ligj, pra vijimi i situatës siç është;
- **Opsioni 1: Hartimi i një ligji “Për titujt e regjistruar mbi produktet bujqësore”;**
- Opsioni 2: Rishikimi i bazës ligjore ekzistuese;

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave dhe është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Efektiviteti në realizimin 100% të planit për rregullimin ligjor të titujve mbi produktet bujqësore - 4
2. Efektiviteti në garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore - 5
3. Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore - 4
4. -- 3 Sigurimi i kuptueshmërisë dhe qartësisë juridike
5. Kosto – efektiviteti - 5

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni1		Opsioni 2	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të planit për rregullimin ligjor të titujve mbi produktet bujqësore	4	0	0	5	20	3	15
Efektiviteti në garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore	5	2	10	5	25	3	15
Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore	4	1	4	3	12	2	8

Aftësia gjyquese në masat e administrative të marra	3	0	0	3	9	1	3
Kosto efektiviteti	5	2	10	4	20	3	15
Pikët totale për secilin opsion			24		86		56

Analiza me shumë kriteret tregon se **opsioni 1- hartimi i një ligji “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”** është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar. Gjithashtu, ky opsion përmbush realizimin e të gjitha objektivave të parashikuara.

Organizata ndërkombëtare IFC/ EëB Group në partneritet me Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës SECO të cilët kanë zyrat e projekteve të tyre edhe në vëndin tonë, kanë marrë përsipër asistimin për një periudhë 3-vjeçare në zbatimin e këtij projektligji pas miratimit të tij.

Asistenca nga ana e tyre do të konsistojë në mbështetjen financiare për krijimin e sistemit të regjistrimit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore në platformën e-Albania, në hartimin e akteve nënligjore, trajnimin e punonjësve të Ministrisë që do të punojnë në njësinë e regjistrimit elektronik, të garantojë kapacitetet institucionale dhe administrative për zbatimin e ligjit si dhe organizimin e aktiviteteve informuese/trajnuese për përmbaruesit, institucionet financiare dhe mikrofinanciare, për fermerët, furnizuesit e lëndëve të para në bujqësi dhe për personat e tjerë të interesuar, në funksion të arritjes së qëllimit final për kontribimin dhe forcimin e një sektori të qëndrueshëm agrorshqimor.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Zbatimi do të realizohet, sipas përcaktimeve të kësaj inisiative ligjore.

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit për dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore do të jenë:

- f) Struktura përgjegjëse për dëftesat tregtare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- g) Kreditori sipas përcaktimeve të dispozitave të këtij projektligji;
- h) Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësore (AREB);
- i) Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU).

Struktura përgjegjëse për dëftesat tregtare në MBZHR, është përgjegjëse për hartimin e politikave, programeve dhe legjislacionit që lidhet me sektorin e dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore. Kjo strukturë do administrojë një regjistër për dëftesat tregtare, i cili do të krijohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në portalin e-Albania sipas përcaktimeve të projektligjit. Gjithashtu do të bëjë koordinimin e procesit me shoqatat e fermerëve, pikat e grumbullimit, rast pas rasti dhe sipas nevojës që do të paraqitet për monitorim do të ketë koordinim me strukturën përkatëse AREB-et që mbulojnë zonat e caktuara.

IFC do të mundësojnë kryerjen e trajnimeve edhe me ekspertë të huaj, promovimin e ligjit me qëllim zbatimin sa më efikas të tij etj. të fermerëve por edhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në fushën e objektit të këtij projektligji.

Risqet mund të jenë disa: nëse vonohet miratimi i akteve nënligjore, zbatimi nga ana teknologjike nuk është i duhuri për t'u përdorur nga fermerët, etj. Të gjitha këto mund t'i vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen. Masat e marra për evitimin e vonesave dhe risqeve janë sic vijojnë:

- Parashikimi i një afati ligjor prej 6 muajsh për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit.
- Parashikimi i një afati ligjor prej 1 viti për të krijuar dhe vënë në funksion sistemin elektronik të dëftesave, regjistrin, në platformën e-Albania.
- Sigurimi i mbështetjes së organizatave ndërkombëtare në zbatimin e këtij projektligji si dhe zbatimi i një plani të përbashkët lidhur me këtë objektiv.
- Parashikimi dhe zhvillimi i moduleve të trajnimit intensiv për fermerët, operatorët e sektorit bujqësor, punonjësit e ekstensionit bujqësor, bankat, institucionet e mikrofinancës etj.

Kjo politikë parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

- Vendim për formatin tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor, të ardhshëm, procedurën elektronike të lëshimit dhe regjistrimit të saj në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, si dhe në regjistrin elektronik të barrëve siguruese mbi produktet bujqësore.
- Vendim për kushtet minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga magazinuesi, në mënyrë që të lëshojë dëftesa tregtare.
- Vendim për formatin tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, procedurën elektronike të lëshimit, të regjistrimit në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, si dhe në regjistrin e barrëve siguruese mbi produktet bujqësore.
- Vendim për procedurën elektronike të lëshimit të dëftesave tregtare, mënyrën, afatet e veprimeve të njësisë të regjistrit elektronik, si dhe detajet e tjera në lidhje me funksionimin e këtij sistemi në platformën e-Albania.
- Vendim që përcakton se cilat janë të dhënat parësore dhe dytësore, ndërveprimin me bazat e të dhënave të tjera, si dhe nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.
- Udhëzim për formatin tip të kontratës elektronike, të dhënies në përdorim të tokës bujqësore.
- Udhëzim për kontratat tip, për tregtimin e dëftesave tregtare, që mund të përpilohen, online në sistemin elektronik të këtyre dëftesave.
- Udhëzim për kontratat tip, për tregtimin e dëftesave tregtare, që mund të përpilohen, online në sistemin elektronik të këtyre dëftesave.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi do të realizohet sipas përcaktimeve të kësaj inisiative ligjore.

Monitorimi në këtë projektligj është parashikuar të kryhet nga kreditori dhe nga njësia përgjegjëse për regjistrin elektronik të dëftesave bujqësore. Konkretisht neni 8 i projektligjit parashikon:

Neni 8

Monitorimi i kolateralit

1. Kreditori ka të drejtë ta monitorojë vetë ose duke përfshirë një palë të tretë, objektin e kolateralit gjatë vlefshmërisë së barrës siguroese, me kusht që debitori të njoftohet nga kreditori të paktën 3 (tri) ditë pune më parë.
2. Monitorimi përmban vëzhgimin e objektit të kolateralit dhe informimin për proceset e tokës bujqësore, me strukturën e magazinimit, mjetet dhe vendet e tjera ku rritet (përgatitet) produkti bujqësor, që është objekt i përpunimit parësor dhe ku magazinohet ai.
3. Kreditori nuk ka të drejtë të ndërhyjë në veprimtarinë e biznesit të debitorit gjatë kryerjes së monitorimit.
4. Kur gjatë monitorimit, kreditori ka arsye të dyshojë mbi sasinë dhe cilësinë e produktit bujqësor, si rezultat i kultivimit ose mbarështimit, magazinimit, transportit dhe përpunimit parësor, ai njofton me shkrim debitorin për këto shkelje dhe kërkon përmirësimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm.
5. Kur debitori nuk plotëson kërkesat e kreditorit mbi shkeljet brenda afatit, kreditori mund të kërkojë përmbushjen e parakohshme të detyrimit ose zbaton mekanizmin e parashikuar në nenin 21, të këtij ligji për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
6. Kur gjëndja mbetet e pandryshuar dhe kreditori vendos të vazhdojë me kultivimi, mbarështimi, magazinimi, transporti dhe përpunimi parësor e produktit bujqësor, debitori është i detyruar të mbulojë shpenzimet shtesë apo të dëmshpërblejë kreditorin.

Ndërsa neni 18, në gërmën “*dh*” dhe “*e*” parashikon:

Neni 18

Njësia përgjegjëse për regjistrin elektronik

1. Njësia përgjegjëse për regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore organizohet dhe funksionon brenda strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

dh) bashkëpunon rast pas rasti me AREBET për ushtrimin e monitorimit në terren, me kërkesë të depozituesit, kur ka arsye për të dyshuar mbi saktësinë e të dhënave apo kur e këtë e vlerëson të nevojshme;

e) njofton AKU-në për ushtrimin e monitorimit të magazinave gjatë magazinimit të produktit bujqësor objekt detyrimi i një dëftese tregëtare për magazinim;

Për secilin prej objektivave është përcaktuar mënyra sesi do të maten, p.sh nëpërmjet regjistrin online të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore do të dalin të dhënat se sa subjekte janë përfshirë, shuma e përafërt e kontraktimit/ financimit, data e lëshimit të dëftesës dhe data se kur dëftesa është shlyer nga debitori, si ka funksionuar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm (kolaterali produk bujqësor), në rastet kur debitori nuk ka kryer vullnetarisht shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër për dëftesën e lëshuar prej tij, etj.

1. Kriter matës do përdoret numri i fermerëve që kanë aplikuar për t`u paisur me dëftesë tregëtare brenda një periudhe 5-vjeçare nga momenti i krijimit dhe funksionimit të regjistrin elektronik të dëftesave tregëtare.

2. Kriter matës do të përdoret numri i subjekteve objekt i këtij ligji që kanë përdorur dëftesën tregëtare si kolateral në banka për të përftuar financim për një periudhë kohore 10-vjeçare nga momenti i miratimit të këtij ligji, dhe sa ka qënë shuma e financimit në raport me përqindjen e zbatueshme sipas huasë bankare
3. Kriter matës do jetë numri i fermerëve që janë paisur me kartë fermeri apo nipt fermeri si rrjedhojë e zbatimit të këtij ligji për një periudhë 5- vjeçare nga momenti i miratimit të këtij ligji.
4. Kriter matës do të jetë sa herë dëftesa tregëtare ka qënë objekt i zbatimit si titull i ekzekutueshëm vullnetar apo i detyrueshëm nga ana e përmbaruesve privatë për një periudhë kohe 10- vjeçare nga momenti i zbatimit të këtij ligji.
5. Kriter matës do të jetë sa parregulltësi ka pasur gjatë procesit të aplikimit, verifikimit të të dhënave nga ana e njësisë përgjegjëse për një periudhë 5- vjeçare nga momenti i miratimit të ligjit.
6. Kriter matës do të jeta sa herë është paraqitur nevoja e ushtrimit të monitorimit nga ana e njësisë, me kërkesë apo më inisiativën e njësisë, në bashkëpunim më AREBET dhe AKU për një periudhë 5- vjeçare nga momenti i miratimit të ligjit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a, N/A Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Opsioni 1

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim	5.2	5.2	5.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë	6	6	6							
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	11.2	10.7	10.2	9.7	9.2	8.8	8.4	8.0	7.6	7.3
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total	90.98									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-90.98									

Opsioni 2

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total	0									
Vlera aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	0									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

N/A

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	90.98	0	-90.98
Opsioni 2	0	0	